



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-056
Prishtinë, më 10 mars 2016,

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 10 MARS 2016**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës përgatitur nga Kryesia e Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit e me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetit z. Ramush Haradinaj, pas dorëheqjes së tij, me deputetin z. Ali Berisha, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Ai i dëshiroi mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kuvend deputetit të ri dhe e ftoi që të ngrihet në këmbë gjersa kryetari i Kuvendit e lexoi tekstin e betimit dhe më pas z. Ali Berisha u betua.

Deputeti z. Ali Berisha e nënshkroi tekstin e betimit.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Alma Lama, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Më pas, kryetari e ndërpreu seancën dhe e caktoi një pauzë prej 10 minutave.

Pas pauzës, seancën e kryesoi nënkryetari Xhavit Haliti.
Ai vazhdoi me pikën nr. 1 të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në vazhdim, deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Labinotë Demi-Murezi, Nuredin Ibishi dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në kohën përderisa diskutonte deputetja Labinotë Demi-Murezi, deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare, përsëri hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Skender Hyseni në lidhje me atë se cila është baza ligjore për suspendimin e policëve Nazmi Jahiri dhe Enver Sejfullahu. A mendoni se Drejtoria e Standardeve brenda Policisë së Kosovës ka rënë nën presionin e politikës, duke e arsyetuar veprimin e ministrit z. Rasim Demiri, i cili ishte gjobitur për shkak të parkimit të veturës në një vend të ndaluar në Prizren. Si do të zgjidhet kjo çështje?
Ministri Skender Hyseni iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me atë nëse do të ketë reciprocitet me Serbinë në raport me çështjen e moslejimit nga shteti serb të hyrjes së kontingjentit me libra shqip të dedikuara për shkollat shqipe në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. A planifikoni t'i drejtoheni BE-së për t'u ankuar për sjelljen e shtetit serb?
Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Abdyl Ymeri parashtoi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me përfundimin e procesit të ndërtimit të objektit të shkollës fillore “Dëshmorët e Çyçavicës” në Çirez dhe objektit të gjimnazit “Hamëz Jashari” në Skenderaj, projekte këto të cilat kanë nisur të realizuari në vitin 2010.
Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Abdyl Ymeri.

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës për fjalë u paraqit deputeti Naser Osmani.

Naser Osmani, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohet pika - *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit*.
Fjala e deputetit Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Në vazhdim, nënkryetari Xhavit Haliti e hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Naser Osmani.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0
Abstenime ----- 0

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Naser Osmani.

Ai konstatoi se pika - *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit* radhitet si pikë me nr. 4 e rendit të ditës për seancën e sotme.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit*
5. *Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë,*
11. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për falimentimin,*
12. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor,*
13. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare,*
14. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,*
15. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,*
16. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin,*
17. *Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
18. *Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie,*
19. *Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.*

* * *

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00 dhe në orën 22:00, si dhe procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19 shkurt 2016, në orën 10:00 dhe në orën 19:00, si dhe procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 26 shkurt 2016.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët për rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Deputeti Naser Osmani, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve rekomandimin lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Diskutimi i deputetit Naser Osmani është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e propozimit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Kujtim Paçaku, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkarkimin e z. Bajram Zogiani nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Bajram Zogiani shkarkohet nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

* * *

Gjatë shqyrtimit të pikës nr. 4 të rendit të ditës, deputeti Ismajl Kurteshi dhe disa deputetë të tjerë nga opozita dolën te foltorja e Kuvendit.

Kryesuesi Xhavit Haliti ia dha fjalën deputetit Ismajl Kurteshi.

Ismajl Kurteshi: Kërkoj në emër të opozitës së bashkuar t’u drejtohet deputetëve që të kontribuojnë në normalizimin e situatës në Kosovë. Në Kosovë nuk ka situatë normale që nga shtatori dhe shkaktarët ju i dini: janë ata që kanë nënshkruar marrëveshje për të cilat Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se janë në kundërshtim me Kushtetutën. Përgjegjësinë për normalizimin e kësaj situate e bëni edhe ju secili veç e veç, edhe si grupe parlamentare.

Derisa Isa Mustafa të jetë në krye të Qeverisë, njeriu i cili e ka shkelur Kushtetutën dhe këtë nuk po e themi ne, këtë e ka thënë Gjykata Kushtetuese më 23 dhjetor dhe ai e ka pranuar që e

ka shkelur këtë Kushtetutë, por nuk po pranon ta tërheqë marrëveshjen e cila ka shkaktuar shkelje, e ka dëmtuar vendin, dhe po vazhdon ta dëmtojë vendin, normalitet nuk do të ketë. Ne, bashkë me qytetarët e Kosovës, të cilët që nga ky vend dhe ky moment i ftoj që të na bashkëngjiten në protestën që e kemi paralajmëruar që do të jetë më 26 mars, në orën 14:00, në sheshin “Skënderbe”, me qëllim të kundërshtimit të Qeverisë së Kosovës, ju ftojme edhe ju që ta jepni kontributin tuaj, edhe në Kuvend, edhe jashtë Kuvendit, që këtë Qeveri të papërgjegjshme dhe të korruptuar ta çojmë në shtëpi.

Prandaj, edhe një herë kërkoj që t’i ndërmerrni veprimet tuaja, të cilat duhet t’i ndërmerrni.

Kërkojmë nga Isa Mustafa i cili ka shkel Kushtetutën të japë dorëheqje dhe të fillojë puna ashtu siç duhet në Kuvendin e Kosovës. Ne tani po shkojmë, ju mëshojuni tupanëve, por normalitet nuk do të ketë derisa situata nuk normalizohet me shkuarjen e Qeverisë.

Unë tash i ftoj kolegët e mi të shkojmë dhe do ta njoftojmë opinionin. Dhe, në fund, skanerët duhet t’i dërgoni në Qeveri që ta skanoni korrupsionin e Isa Mustafës dhe të kësaj Qeverie. Nuk ka nevojë të blihen skanerë, se ne nuk do të jemi objekt i skanerëve. Faleminderit!

Kryesuesi Xhavit Haliti: Faleminderit Zoti Salih Salihu, faleminderit që më preve në besë! Atëherë, unë i kërkoj falje zotit Mustafa që ia hodhën një çik ujë, por s’është ndonjë problem. Ne jemi këtu, jemi pozitivë e fuqishme, do të vazhdojmë me seancën. Besoj që nuk ka nevojë që të diskutojmë për këtë çështje.

Më pas, për diskutim u paraqitën edhe deputetët: Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të GP të LDK-së, si dhe kryeministri Isa Mustafa.

Adem Grabovci: Pajtohem me përpjekjet tua dhe tonat të gjitha të përbashkëta për të kontribuar, për të mos lejuar eskalimin e situatës, për të bërë përpjekje dhe për ta dhënë maksimumin tonë të mundshëm në fuqizimin e shtetit, në funksionalizimin dhe në mbështetjen e institucioneve tona, mirëpo kjo që është duke ndodhur në Parlamentin e Kosovës dhe në vendin tonë tani e shtatë muaj rresht është diçka e paparë, është e kundërligjshme, është e papranueshme dhe është e dënueshme.

Këtu në këtë institucion më të lartë të vendit vendimmarrës, këta deputetë e këto deputete i janë nënshtruar një dhune të paparë, ku u është rrezikuar edhe jeta e tyre, por e kanë dhënë maksimumin e mundshëm që të mos lejojnë tentimin e bllokimit dhe shkatërrimin e shtetit. Shpreh keqardhjen për një pjesë të opozitës që ka hyrë në agjendë të huaj, të atyre të cilët e kanë mision shkatërrimin e shtetit.

Unë i bëj thirrje edhe kryeministrit, edhe organeve të drejtësisë, edhe organeve të rendit që ta japin maksimumin e vet dhe t’i respektojnë ligjet, ta respektojnë Kushtetutën dhe t’i kryejnë e t’i përmbushin obligimet e tyre ligjore. Ju lutem, a ka krim më të madh, a ka absurditet më të madh se sa në shtet të sulmohet kryeministri i vendit, të arrestohen njerëzit dhe pas tri, katër orë, apo pas një dite të lirohen aktorët?

I bëj pyetje vetvetes, ju dhe çdo qytetari të Republikës së Kosovës, a është drejtësi kur gjykatat tona u krijojnë mundësi atyre, të cilët e kryejnë krimin të dënuar dhe u mundësojnë për t’u kthyer prapë në vendin e krimit për të vazhduar veprën e njëjtë?

Ku janë duke na çuar këto veprime? A duam të kemi shtet, a s’duam të kemi shtet? I kemi fyer të gjithë miqtë tanë. E kemi lënduar shpirtin, zemrën e çdo qytetari të Republikës së Kosovës

që e do, që mendon për vendin e vet, për familjen e vet, për fëmijët e vet, për perspektivën e fëmijëve të vetë.

Prandaj, kjo është e palejueshme dhe mendoj, kolegë të nderuar deputetë, ne nuk mund të vazhdojmë deri në pafundësi në këtë formë.

Teuta Sahatqija: Deri më tash kemi qenë për muaj të tërë të helmuar prej gazit në Kuvendin e Kosovës. E di se shumë prej deputetëve ankohen për probleme me frymëmarrje, po përsëri me dhembje koke e me probleme të tjera shëndetësore, duke marrë doza të njëpasnjëshme në Kuvendin e Kosovës. Por, pa marrë parasysh atë, ne po qëndrojmë këtu dhe po tentojmë që të arsyetojmë atë votën, të cilën qytetarët na e kanë dhënë dhe për të cilën ne jemi betuar, së bashku edhe me një deputet i cili sot e dha betimin, se do të punojmë për Kosovën.

Ne nuk kemi një shtet rezervë, në mënyrë që çfarëdo që të ndodhë me këtë, të shkojmë diku tjetër.

Secili prej nesh e di që ka mjaftë probleme, por ato probleme mund të zgjidhen me bashkëpunim pozitiv e opozitë. Çdoherë në Kuvend ka pasur pozitiv dhe opozitë dhe secila palë përmes mjeteve demokratike ka tentuar që të japë kontributin dhe që këto probleme, me të cilat ne si shtet i ri po ballafaqohemi, t'i tejkalojmë dhe ta ndërtojmë Kosovën, se e kemi vetëm këtë, ta ndërtojmë në një shtet të duhur.

Prandaj, shpresoj që opozita në vend të thirrjes për aktivitete jashtë Kuvendit, të kthehet në Kuvend dhe të japë kontributin e vet në mënyrë demokratike për të përmirësuar gjendjen në Kosovë.

Kryeministri Isa Mustafa: Nuk shoh asnjë arsye që opozita të sillet kështu, nuk shoh asnjë arsye që opozita të na sulmojë, qoftë brenda në Kuvend, qoftë jashtë Kuvendit, dhe po ashtu nuk shoh arsye që shteti të mos funksionojë ashtu si duhet të funksionojë.

Nuk jemi ne të Qeverisë që duhet të tregojmë dhe instruktojmë institucionet e vendit, edhe ato të drejtësisë, edhe të tjerat, se si duhet ta bëjnë punën e tyre, por të gjithë ne duhet të kërkojmë që shteti të funksionojë dhe çdonjëri të përgjigjet para ligjit për veprimet e tyre.

Unë jam kryeministër i vendit, nuk jam shenjë që kujt t'i teket të gjuajë në mua këtu, as Brenda Kuvendit, as jashtë Kuvendit, dhe mendoj që këtë s'duhet ta lejojnë organet e drejtësisë.

S'duhet të lejojnë as të më sulmohet shtëpia. Unë s'kam dashur të deklarohem publikisht, sepse kam menduar që organet duhet ta bëjnë punën e tyre, por në qoftë se një shtëpi e kryeministrit në Kosovë sulmohet me shishe molotovi dhe heshtin të gjithë, atëherë diçka nuk është në rregull në këtë vend.

Në qoftë se njerëzit e përsëritin veprën pandërprerë këtu në Kuvend dhe i pengojnë 120 deputetë që ta bëjnë punën e tyre, atëherë s'mund të themi se të gjithë ne po bëjmë detyrën tonë, sepse Kuvendi duhet të funksionojë dhe do të funksionojë, Qeveria duhet të funksionojë dhe ju garantoj se ka për të funksionuar.

Sikur unë ta konsideroja veten si shkelës i Kushtetutës, ju garantoj se sot do të dilja para jush dhe do t'u kërkoja falje juve, Lidhjes Demokratike të Kosovës në krye të së cilës jam, qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe do tu thosha se është shkelur Kushtetuta dhe si konsekuencë e shkeljes së Kushtetutës unë e bart përgjegjësinë time. Unë ju garantoj se nuk e

kemi shkelur asnjë pikë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, asnjë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka dhënë mendimin e saj lidhur me marrëveshjen, Gjykata Kushtetuese ka thënë, se marrëveshja e parë është bërë normë juridike dhe ajo duhet të zbatohet, sepse me Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes së parë Kosova ka marrë obligim që ta themelojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Ndërkaq, Gjykata Kushtetuese ka thënë se si duhet të themelohet ky asociacion, në mënyrë që të mbrohet fryma kushtetuese, sepse Gjykata Kushtetuese nuk e ka interpretuar asnjë nen të Kushtetutës se është shkelur, por ka thënë se fryma kushtetuese është kështu dhe se asociacioni duhet të bëhet mbi bazën e frymës kushtetuese.

Dhe, unë dhe Qeveria kemi marrë për obligim që më tutje ta respektojmë pikë për pikë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Vetë fakti që në marrëveshjen për parimet, jemi përcaktuar që këtë marrëveshje t'ia dërgojmë Gjykatës Kushtetuese dhe këtë e ka pranuar Brukseli dhe e ka pranuar edhe pala serbe, flet se ne kemi qenë të kujdesshëm ashtu që në asnjë moment të mos shkelet Kushtetuta, se nuk është shkelje Kushtetutës në qoftë se në marrëveshje thuhet, se marrëveshja i dërgohet Gjykatës Kushtetuese dhe se Asociacioni do të themelohet mbi bazën e vërejtjeve, sugjerimeve dhe mendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, kjo nuk mund të shërbejë si kauzë, nuk mund të shërbejë si e drejtë për t'i ftuar qytetarët që ta sulmojnë vendin e tyre, ose e drejtë që opozita me mjete të dhunshme të kryejë veprime.

Unë e ftoj opozitën prapë që të kthehet, të marrë pjesë në debat, që t'i thotë të gjitha vërejtjet që i ka lidhur me asociacionin, lidhur me demarkacionin, lidhur me mënyrën se si ne do ta zhvillojmë dialogun në të ardhmen, sepse ata përfaqësojnë një pjesë të votës së qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe qytetarët e Republikës së Kosovës nuk e kanë votuar asnjë deputet, as ata të opozitës, për të ardhur e gjuajtur gaz lotsjellës në sallën e Kuvendit, ata i kanë votuar që të marrin pjesë këtu dhe që në mënyrë konstruktive t'i paraqesin mendimet dhe të kundërshtojnë, sepse kanë të drejtë të kundërshtojnë pozitën, por atë ta bëjnë me fakte, me argumente dhe në mënyrë demokratike. Nuk është mënyrë demokratike kjo si po veprojnë njerëzit e opozitës.

5. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068, ia ka parashtruar Kuvendit propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Kryetari i Kuvendit ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që Kuvendit t'i propozoj tre gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka propozuar tre (3) gjykatës të cilët do ta përbëjnë Organin Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Kryesuesi hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo nuk diskutoi askush.

Kryesuesi e hodhi në votim Formimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur emërohen:

1. Valdete Daka, gjyqtare në Gjykatën Supreme të Kosovës,
2. Asllan Krasniqi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë,
3. Nebojsa Boriçi, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës.

II. Ngarkohet Organi Përzgjedhës i Pavarur që, në pajtim me dispozitat e nenit 100.3 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092, ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e Kryesuesit dhe dy (2) anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Kuvendit t’ia paraqes raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për gazin natyror.

Ministri Blerand Stavileci tha se ky projektligj parasheh krijimin e kornizës ligjore për transmision, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe deponimin e gazit natyror.

Më tej ai theksoi se Projektligji përcakton organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen ndaj tregut si dhe kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve për transmision, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe deponimin e gazit natyror dhe operimin e sistemeve.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Blerand Stavileci është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Besim Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Blerim Grainca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Kujtim Paçaku, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Gazin Natyror.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për gazin natyror.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Ministri Blerand Stavileci tha se ky projektligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmisionit në sektorin e energjisë, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Blerand Stavileci është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Raif Qela, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për energjinë elektrike.

Ministri Blerand Stavileci tha se ky projektligj përcakton rregulla dhe masa për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike, me çmime reale, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të tij.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Blerand Stavileci është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Besim Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Blerim Grainca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për energjinë elektrike.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për energjinë elektrike.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për energjinë.

Ministri Blerand Stavileci tha se ky projektligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen veprimtaritë në sektorin e energjisë në vend, me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt dhe cilësor me energji, duke promovuar shfrytëzimin më eficient të saj, rritjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe planifikimin e zhvillimit të sektorit të energjisë.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Blerand Stavileci është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Raif Qela, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për energjinë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për energjinë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë

Ministri Arban Abrashi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e tërhoqi këtë Projektligj nga procedurat parlamentare.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për falimentimin

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për falimentimin.

Ministrja Hykmete Bajrami tha se ky projektligj rregullon dh përcakton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me falimentimin dhe josolvencën e shoqërive tregtare, dispozitat për mbrojtjen, likuidimin dhe shpërndarjen e aseteve të debitorit falimentues te kreditorët dhe dispozita për riorganizimin dhe lirimin nga borxhi për shoqëritë tregtare.

Në vazhdim, ajo foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministres Hykmete Bajrami është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Besim Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për falimentimin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për Falimentimin.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor.

Ministri Lutfi Zharku tha se ky projektligj përcakton bazat kryesore të ndërsjella të marrëdhënieve dhe sjelljeve të pjesëmarrësve si dhe subjekteve tjera në komunikacionin rrugor, kushtet bazë që duhet ti plotësojnë rrugët nga aspekti i sigurisë rrugore, sistemi i sinjalizimit, shenjat që japin personat e autorizuar zyrtar, detyrat në rast aksidenti në komunikacionin rrugor, kushtet për drejtimin e mjetit, pajisjet dhe pajimet të cilat duhet ti kenë mjetet, dimensionet, masa më e madhe e lejuar, ngarkesa boshtore e mjetit, si dhe kushtet të cilat duhet ti plotësojë mjeti në komunikacionin rrugor.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Lutfi Zharku është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Blerim Grainca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për punë në veprimtarinë minerare.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime.

Kryesuesi, më pas hodhi në votim të gjitha amendamentet, një nga një.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet nga 1 - 29.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-062 për punë në veprimtarinë minerare.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për mjekësinë ligjore.

Kryesuesi hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës, por nuk kishte asnjë deputet të paraqitur për diskutim.

Kryesuesi, më pas hodhi në votim të gjitha amendamentet, një nga një.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet nga 1 - 9.

Më tej, kryesuesi hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/L-060 për mjekësinë ligjore.

15. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Integritet Evropian, ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij, me ndryshimin e propozuar.

Kryesuesi hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Teuta Sahatqija, në emër të Komisionit për Integritet Evropian; Luljeta Veselaj-Gutaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Kujtim Paçaku, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Muhamet Mustafa dhe ministri Bekim Çollaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, bashkë me ndryshimin e propozuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për----- 63,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi rekomandimin e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, bashkë me ndryshimin e propozuar.

16. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mbikëqyrur zbatimin të Ligjit për standardizimin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Deputeti Fatmir Rexhepi, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin. Diskutimi i deputetit Fatmir Rexhepi është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin.

17. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kërkoi nga grupet parlamentare që të propozojnë kryesuesin, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Fjala e kryesuesit është dhënë e plotë në transkript.

Pas paraqitjes së propozimeve nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryesuesi hodhi në votim propozimet për kryesues, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kuvendi përmes një votimi formal me ngritje dore miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Selvije Halimi, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. _____, nga GP i LVV-së, zv/kryesues/e i/e parë,
3. Fikrim Damka, nga GP “6+”, zv/kryesues i dytë,
4. Xhevahire Izmaqu, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Alma Lama, nga GP i LDK-së, anëtare,
6. Doruntinë Maloku, nga GP i LDK-së, anëtare,
7. _____, nga GP i AAK-së, anëtar/e,
8. Nenad Rashiç, nga GP i LS-së, anëtar,
9. _____, nga GP “Nisma për Kosovën”, anëtar/e.

II. Komisioni Ad-hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedh kandidaturat e paraqitura për anëtar të Bordit të Radio televizionit të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

18. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesuesi, fillimisht, kërkoi nga grupet parlamentare që të propozojnë kryesuesin, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie.

Fjala e kryesuesit është dhënë e plotë në transkript.

Pas paraqitjes së propozimeve nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryesuesi hodhi në votim propozimet për kryesues, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie.

Kuvendi përmes një votimi formal me ngritje dore miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Medie, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqu, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. _____, nga GP i AAK-së, zv/kryesues/e i/e parë,

3. Adem Hoxha, nga GP LS, zv/kryesues i dytë,
4. Zenun Pajaziti, nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Naser Osmani, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Sali Morina, nga GP i LDK-së, anëtar,
7. _____, nga GP i LVV-së, anëtar/e,
8. Danush Ademi, nga GP “6+”, anëtar,
9. _____, nga GP “Nisma për Kosovën”, anëtar/e.

II. Ngarkohet Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Medie dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

19. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesuesi e njoftoi Kuvendin me propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, si dhe të Grupit Parlamentar “6+” për zëvendësimin anëtarëve në komisionet parlamentare.

Pas hedhjes në votim të propozimeve të lartpërmendura, kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së emërohen anëtarët, si në vijim:

1. Deputeti Abdyl Ymeri emërohet anëtar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike,
2. Deputeti Bislim Zogaj emërohet anëtar në Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian.

II. Nga Grupi Parlamentar “6+” bëhet emërimi, si në vijim:

1. Deputeti Fikrim Damka emërohet zv/kryetar i dytë i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetes Duda Balje.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor*